

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU  
PËR NDIHMËN  
JURIDIKE FALAS

**PYETJE QË SHTROHEN SHPESH NË LIDHJE ME  
LIDHJEN E MARTESËS DHE SHKURORËZIMIN**

## SI LIDHET MARTESA?

**Martesa mund të lidhet vetëm ndërmjet një burri dhe një gruaje. Të dy duhet të jenë persona madhorë. Të dy duhet të dëshirojnë që të hyjnë në atë martesë.**

Për lidhjen e martesës, duhet të dorëzoni paraqitje në Drejtorinë për mbajtjen e librave të amzës në vendbanimin tuaj. Do të duhet të dorëzoni dokumentet që do të vërtetojnë se ju personalisht e lidhni martesën (certifikatë nga libri amzë i të lindurve), se nuk jeni të afërm (vëlla, motër, kushëri, nënë, baba) se nuk jeni në martesë tjetër në atë moment.

Martesa mund lidhet në hapësirat e Drejtorisë për mbajtjen e librave të amzës, por mund të merreni vesh edhe për vend tjetër (në restorant, në hapësira tjera). Nëse vendosni për këtë mundësi, do të duhet të paguani vlerë të shtuar të cilën do ua tregojnë të punësuarit në Drejtori.

**Lidhja e martesës para Drejtorisë për mbajtjen e librave të amzës është akt solemn.** Kjo do të thotë se në momentin e lidhjes të martesës **mund të keni të ftuar** të cilët do të jenë bashkë me ju për të festuar momentin. Martesa është lidhur kur në librin për mbajtjen e librave amzë të të martuarve do të nënshkruheni ju – personat të cilët do të hyni në martesë, ofiqari dhe dy dëshmitarë të cilët i zgjidhni ju vetë.

Pastaj, do të merrni dokument – **Certifikatë nga libri amzë i të martuarve.** Kjo do të thotë se **martesa është lidhur dhe regjistruar në librat e amzës.**

## ME BASHKËSHORTIN JETOJMË BASHKË DISA VITE, POR NUK JEMI NË MARTESË. A ËSHTË KJO NË NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN?

Nëse bashkë me bashkëshortin keni vendosur që të jetoni bashkë pa lidhur martesë, kjo është plotësisht në rregull me ligjin.

Nëse jetoni bashkë një apo më shumë vite në bashkësi jashtëmartesore, ju keni të drejta dhe detyrime të barabarta për mbajtje reciproke dhe pronësi në pronën që keni fituar në atë bashkësi, si dhe personat të cilët janë në martesë.

## KEMI HYRË NË MARTESË. A KA DIKUSH PREJ NESH MË SHUMË TË DREJTA SE TJETRI?

Bashkëshortët janë të barabartë në martesë, respektivisht kanë të drejta dhe detyrime të barabarta. Këto të drejta dhe detyrime i referohen marrjes të vendimeve në shtëpi, numrit të personave dhe edukimit të tyre, fitimit të pronës, të drejtën në punë dhe të ngjajshme.



## U MARTOVA JASHTË VENDIT. ÇFARË TË BËJË PËR PARAQITJEN E MARTESËS KËTU?

Procedura për paraqitjen e martesës të lidhur jashtë vendit zhvillohet para Drejtorisë për mbajtjen e librave të amzës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesë për regjistrimin e martesës;
- Letërnjoftim apo pasaportë në këqyrje;
- Certifikatë nga libri amzë i të martuarve të lidhur jashtë vendit, me përkthim në gjuhën maqedonase nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor, apo certifikatë ndërkombëtare.

Për procedurën paguhet taksë administrative prej 50,00 denarë.

## SI TË SHKURORËZOHEM?

Në varësi nga ajo nëse dy bashkëshortë duan që të shkurorezohen, procedura për shkurorezim - mund të inicohet me **Propozim për shkurorezim me marrëveshje (ujdi)** apo **me padi për shkurorezim**.

Pas inicimit të procedurës, gjykata, dhe nëse në martesë ka persona të mitur, qendra për punë sociale, zbaton procedurë për pajtim, **përveç kur nuk ekzistojnë kushte për pajtim**, të vërtetuara me ligj.

Nëse në martesë ka persona të mitur të cilat duhet t'i ndahen njërit prind për edukim dhe ruajtje, në procedurën gjyqësore përfshihet Qendra për punë sociale, që jep mendimin e saj për atë se kujt duhet t'i ndahen fëmijët.

Procedura gjyqësore përfundon **me aktgjykim për shkurorezim, ndarjen e fëmijëve të mitur për edukim dhe ruajtje te njëri prind, dhe detyrimin e prindit tjetër për të paguar mbajtjen mujore**.

## ÇFARË NDODHE ME FËMIJËT PAS SHKURORËZIMIT?

Pasi të sillet aktgjykimi për shkurorëzim, fëmijët mbesin në kujdes, ruajtje dhe edukim të prindi të cilin e ka përcaktuar Gjykata në bazë të gjetjes dhe mendimit të Qendrës për punë sociale. Prindi tjetër ka detyrimin që të paguajë mbajtjen mujore.

Fëmijët kanë të drejtë që të takohen dhe të kenë komunikim të pandërprerë me të dy prindët. Për këtë Qendra për punë sociale përgatit Aktvendim për organizimin e takimeve të fëmijëve me prindin me të cilin nuk jetojnë. Në varësi nga marrëveshja, këto takime mund të jenë disa orë, disa ditë, në fundjavë, festa, pushime vjetore, dhe të ngjajshme.

## SI TË NDAJMË PRONËN E FITUAR NË MARTESË?

Ndarja e pronës të fituar në martesë **kryhet pasi që të përfundojë procedura gjyqësore për shkurorëzim**. Kjo është procedurë e re gjyqësore, në të cilën vendoset ekskluzivisht për sendet të cilat janë të fituara në martesë.

Është me rëndësi që të përmendet se nuk ndahen vetëm **sendet e luajshme dhe të paluajshme të fituara në martesë, por edhe borxhet që janë shkaktuar në bashkësinë martesore**. Për shembull, nëse është marrë kredi, e njëjta është detyrim i fituar në martesë, dhe duhet të përfshihet në masën e ndarjes.



Nuk ndahen pronat të cilët bashkëshortët i kanë patur para lidhjes të martesës, prona e fituar nga ana e njërit bashkëshort si trashëgimi apo dhuratë, dhe sendet e fituara në martesë të cilat ekskluzivisht shërbejnë për kryerjen e nevojave personale të njërit bashkëshort, nëse nuk paraqesin vlerë joproporcionalisht të madhe në krahasim me vlerën e pronës të përgjithshme të përbashkët.

Për realizimin e saktë të ndarjes, nevojitet që të bëhet vlerësimi i pronës, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet dy bashkëshortëve nga ana ekspertit të autorizuar.

Aktgjykimi i plotëfuqishëm gjyqësor më tutje paraqet bazë për regjistrim të ndryshimeve në fletët e pronësisë, lejet e qarkullimit, kontratat e kredisë, lizingun dhe të ngjajshme.

## DUAR TË UDHËTOJË JASHTË SHITIT ME FËMIJËT. SI TË MARRË PËLQIM NGA PRINDI TJETËR?

Nëse dëshironi që të udhëtoni në mënyrë të pavarur me fëmijë të mitur, pavarësisht nëse jeni në martesë apo jo, dhe pavarësisht nëse shkoni për disa ditë apo periudhë më të gjatë, nevojitet pëlqimi nga prindi që nuk udhëton.

Nëse prindi refuzon që të jap pëlqim të tillë, keni të drejtë të kërkonti nga Qendra për punë sociale që të intervenojë.

## KA NDËRRUAR JETË BASHKËSHORTI ME TË CILIN ISHA 20 VJET NË MARTESË. ÇFARË DUHET TË BËJË QË TË PËRMBUSH PROCEDURAT LIGJORE?

Detyra e parë për familjen pas vdekjes të një personi është që të paraqes personin për të vdekur në Drejtorinë për mbajtjen e librave amzë, në vendbanimin ku ka banuar personi herën e fundit. Këtë paraqitje mund ta bëjë bashkëshorti apo fëmijët, nëse janë persona madhor.

Nëse ju nuk mundeni, mund të jepni autorizim një personi tjetër madhor që ta bëjë këtë në vendin tuaj.

Paraqitja bëhet me plotësim të kërkesës (të cilën e keni në sportelet e Drejtorisë), dorëzimin e vërtetimit për vdekjen (e lëshon spitali), dhe certifikatë nga libri amzë i të lindurve të personit që ka ndërruar jetë.

Paraqitja duhet të realizohet në afat prej 30 ditësh nga paraqitja e vdekjes.



## BASHKËSHORTI I VDEKUR KISHTE NJË BANESË, AUTOMJET DHE KURSIM TË VOGËL NË BANKË. KUJT I TAKOJNË KËTO MJETE?

Prona e personit të ndjerë (të vdekur) trashëgohet nga trashëgimtarët e tij – bashkëshorti apo bashkëshortja, dhe fëmijët e tij. Nëse personi nuk ka qënë në martesë apo nuk ka fëmijë, pronën e trashëgojnë prindërit dhe vëllezërit dhe motrat e tij.

Në rast se pronën e trashëgojnë bashkëshorti-bashkëshortja dhe fëmijët, secili prej këtyre personave ka të drejtë në pjesën e tij, dhe të gjithë pjesët janë të barabarta. Kjo vlen edhe kur trashëgimtarët janë djem, edhe kur trashëgimtarët janë vajza.

## SI TË ZBATOJMË PROCEDURËN E TRASHËGIMISË?

Që të zbatoni trashëgiminë, nevojitet që të inicioni procedurë për trashëgimi (procedurë trashëgimore).

Kjo procedurë fillon me dorëzimin e kërkesës për fillimin e procedurës trashëgimore deri te gjykata që ndodhet në vendin ku ka banuar personi para se të ndrojë jetë.

Procedurën mund ta iniciojë secili trashëgimtar, por më së mirë nëse është e mundur, në kërkesë të nënshkruhen të gjithë trashëgimtarët, sepse kështu përjashtohet mundësia që dikush të harrohet.

Често поставувани прашања поврзани со склучување и развод на брак





Bashkangjitur me kërkesën duhet të dorëzoni edhe dëshmi – certifikata nga libri amzë i të vdekurve, të lindurve dhe të martuarve, dhe dëshmi për pronësi mbi sendet të cilat trashëgohen – banesë (fletë të pronësisë), automjet (leje të qarkullimit) para (librezë kursimi dhe certifikatë nga banka.

Pastaj gjykata cakton noterin i cili do ju thërrasë në zyrën e tij që të zbatoni procedurën.

**Me rëndësi:** Ju mundeni që vetë të dorëzoni kërkesën për zbatimin e procedurës trashëgimore, por për procedurën para noterit duhet të keni avokat, që t'ju sqarojë çdo hap të procedurës dhe të kujdeset që trashëgimia të realizohet ashtu siç jeni marrë vesh. **Nëse nuk keni të mjete ju këshillojmë që të dretoheni në zyrat për ndihmë juridike falas të Ministrisë të drejtësisë, organizatat joqeveritare të regjistruara për ndihmë juridike falas apo klinikat juridike, që të kontrollojnë nëse ju takon avokat falas, dhe nëse ju takon, t'ju ndihmojnë në plotësimin e kërkesës.**



## A MUND TË TËRHIQEM NGA TRASHËGIMIA?

**Sigurisht.** Kjo është e drejta juaj edhe kur noteri do të pyes nëse e pranoni trashëgiminë, mund të thoni se tërhiqeni nga e njëjta.

Mund të tërhiqeni nga vetëm një pjesë e trashëgimisë (për shembull, vetëm nga automjeti), dhe të pranoni pjesë tjetër (për shembull, pjesë të banesës).

Pjesa nga e cila tërhiqeni ndahet mes trashëgimtarëve tjerë.



## KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	





INFORMOHU  
PËR NDIHMËN  
JURIDIKE FALAS

[www.pravnapomos.mk](http://www.pravnapomos.mk)

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.  
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë